



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 137/5 Prot

Tiranë më 13 . 05 . 2015

V E N D I M

Nr. 47 , datë 13 / 05 / 2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil
Njësia Bashkiake nr. 8, Tiranë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar); neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes të zhvilluar në Njësinë Bashkiake nr.8, Tiranë

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 4, datë 28.01.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake nr.8, Tiranë*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar kryesisht mbikëqyrjen tematike në subjektin, Njësia Bashkiake nr.8, Tiranë.

Objekti i mbikëqyrjes është i kufizuar në disa institute të ligjit, si deklarimi i statusit të punësimit për punonjësit e institucionit që kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si detyrim i parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 67 të ligjit "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në kapitullin që bën fjalë për dispozitat kalimtare; përshkrimi i punës dhe verifikimi i përmbushjes së kërkesave për pranimin në shërbimin civil, nga ana e nëpunësve të cilët kryejnë funksionet në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.

Procesi është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes me nr. 137/2 prot., datë 28.01.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 137/1 prot., datë 28.01.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 137/3, datë 30.03.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Pas kësaj faze procedurale, rezulton se projektraporti është kthyer pranë Komisionerit, pa observacione nga ana e institucionit të mbikëqyrur dhe i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, rregjistruar me nr. rregj. 137/4, datë 27.04.2015.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijon me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin Njësia Bashkiake nr.8, Tiranë, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia Përgjegjëse të marrë masat për revokimin e aktit administrativ nr. 17, datë 18.07.2014, për emërimin e punonjës ***** në pozicionin "*Përgjegjëse e Sektorit të Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban*", si një akt që ka dalë në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë, kjo punonjëse të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës si "*Specialiste në Zyrën e Informimit Qytetar*", ku është deklaruar me statusin e nëpunësit civil.

Në këtë rast, rekomandohet Sektori i Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, që vendin e punës "*Përgjegjës Sektori të Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban*" ta shpallë vend të lirë, për t'u plotësuar më tej sipas procedurave ligjore.

3. Njësia Përgjegjëse të marrë masat për revokimin e aktit administrativ nr. 28, datë 01.04.2014, për emërimin e punonjës ***** në pozicionin, "*Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Ekonomike*", si një akt që ka dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar) dhe për pasojë, kjo punonjëse të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës si "*Specialiste në Sektorin e Burimeve Ekonomike*", ku edhe është deklaruar me statusin e nëpunësit civil.

Në këtë rast, rekomandohet Sektori i Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, që vendin e punës “*Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Ekonomike*” ta shpallë vend të lirë, për t’u plotësuar më tej sipas procedurave ligjore.

4. Njësia përgjegjëse, të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për punonjësën ***** , si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve*” dhe të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në ASPA, përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori; dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin, ose jo të nëpunëses në këtë pozicion.
5. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktet administrative që bëjnë fjalë për punonjësit ***** , emëruar në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Burimeve Ekonomike*” , me aktin administrativ nr. 316, datë 02.04.2014, të titullarit të institucionit dhe ***** , emëruar në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Informimit Qytetar*” me aktin nr. 746, datë 04.08.2014, të titullarit të institucionit, si akte që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe me procedurën e kërkuar për emërimin në këto raste.
6. Sektori i Burimeve Njerëzore, të nxjerrë Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, për punonjësën ***** , e punësuar në pozicionin “*Specialist Tregu*”, sipas rekomandimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Njësia përgjegjëse të verifikojë plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të deklarojë statusin e punësimit për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, ***** , “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”; ***** , “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”; ***** , “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”.
8. Njësia e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithëshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike, të drejtojë procesin e hartimit të përshkrimit të punës për pozicionet që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile, sipas formatit standard të miratuar në aktet ligjore dhe nenligjore që rregullojnë këtë institut, në përputhje me rekomandimet e materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim, duke marrë parasysh se zbatimi i tij kërkon një kohë të kushtëzuar nga afatet procedurale të veprimeve që duhet të kryhen në këtë rast për rregullimin e situatës.
10. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
11. Me kalimin e këtij afati, institucioni të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

12. Për këtë vendim të njoftohet subjekti, Njësia Bashkiake nr. 8, Tiranë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA